

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI
TË KUFIZUAR
SALLA CONSTRUCTION Sh.p.k.**

- Z. Kristjan Salla, atësia Gëzim datëlindje 25.06.2001, lindur në Plangaricë, Elbasan dhe banues në Bërzhitë, Ndertesa Nr.232, Bërzhitë, Kodi postar 1037, Tiranë , me kartë identiteti ID **nr.039435417** dhe **nr.personal K10625021P**

ka vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

Neni 1 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është **SALLA CONSTRUCTION Sh.p.k.**

Neni 2 - Selia

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, Bërzhitë, Ndertesa Nr.232, Bërzhitë, Kodi postar 1037, Tiranë.

Neni 3 - Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

Neni 4 - Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

- Punime të specializuara në ndërtim si shtrim pllakash,shtrim parketi, nivelime, mermer, izolime, veshje dekorative, veshje fasade. Karpentier, hekurthyes, punime armature, punime karpenterie metalike, druri. Punime të ndryshme ndërtimi, punime suvatime, gipsi, dekoracione, sisteme kapot etj.

pllakat mermeri shtrim parketi ,veshje dekorative , veshje fasade

Neni 5 - Kapitali themeltar

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) lekë i cili nuk është i paguar.

5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar ne nenin 6 (gjashtë) të ketij Akti.

Neni 6 - Kontributet

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Kristjan Salla, atësia Gëzim datëlindje 25.06.2001, të cilit i përket 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100,000 lekë që i korespondon 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Neni 7 - Transferimi i kuotave

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

Neni 8 - Administrimi



8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Kristjan Salla, atësia Gëzim datëlindje 25.06.2001 lindur në Plangaricë, Elbasan dhe banues në Bërzhitë, Ndertesa Nr.232, Bërzhitë, Kodi postar 1037, Tiranë , me kartë identiteti ID nr.039435417 dhe nr.personal K10625021P , emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryrjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

Neni 9- Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

SALLA CONSTRUCTION Sh.p.k.

Kristjan Gëzim Salla

Kristjan Salla

Data: 16.09.2024

